REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 301, Datë 20.10.2026

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 164, DATË 15.08.2024 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "NOVA PROSPECT" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3090, prot., datë 15.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024 "Mbi licencimin e shoqërisë "NOVA PROSPECT" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike"*

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "NOVA PROSPECT" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin 164, datë 15.08.2024, vendosi të licencojë shoqërinë "Nova Prospect" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2960, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 30.08.2024.
  Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohet se "*Shoqëria "NOVA PROSPECT" sh.p.k. të raportojë në ERE çdo 3 (tre) muaj në lidhje me qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për njoftimin e bërë nga ana e saj për ndryshimin e vlerës së investimit të projektit, dhe të depozitojë menjëherë në ERE këtë qëndrim apo amendim, në rast se pajiset me të".* Në pikën 3 përcaktohet se "*Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të tij"*.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në kuadër të rakordimit të plotësimit të kushtit të sipërcituar, rezulton se shoqëria ka bërë me dije se ka raportuar rregullisht në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), çdo 3 muaj dhe se në datën 01.11.2025 i ka dërguar shkresë sërish për vënien në dijeni të vlerës së investimit (kjo në referencë të përcaktimeve të nenit 8.2 të Kontratës nr. 4330 rep., nr. 1983 kol., datë 07.11.2022 të nënshkruar me MIE-n), por nuk ka pasur kthim përgjigjeje.
- Nga të dhënat që ERE disponon në kuadër të raportimeve mujore të depozituara nga shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL) sh.a., rezulton se shoqëria "NOVA PROSPECT" sh.p.k. ka hyrë në operim në muajin tetor 2024, që do të thotë se projekti ka kaluar në fazën e shfrytëzimit.
- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se shoqëria ka njoftuar MIE-n për ndryshimin e vlerës së investimit, në përputhje me detyrimin e përcaktuar në nenin 8.2 të kontratës, i cili

parashikon njoftimin përkatës, dhe nuk rezulton të jetë administruar në ERE një qëndrim i ndryshëm nga MIE lidhur me këtë njoftim, si dhe duke marrë në konsideratë se centrali ka përfunduar ndërtimin dhe ka hyrë në operim, vlerësohet të vijohet me shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr. 164/2024.

Nevoja për rishikimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"* parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet nga organi kompetent me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 164, datë 15.08.2024, si vijon:

   a) Pika 2 e vendimit, shfuqizohet.
   b) Pika 3 e vendimit, ndryshon dhe bëhet:

   3. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "NOVA PROSPECT" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI